



A  
KA  

---

**SIGURI**

---

  
NË  
  
KUR'AN?

*Sura 4:17, 116*

**The**  
**Berean**  
**Call**

KORRIK 2010

INKUIZICIONI I RI

nga DAVE HUNT

# THIRRJA BEREASVE

«[Bereasit] ... i shqyrtuan çdo ditë shkrimet, [për të parë] nëse këto gjëra ishin ashtu». - VEPRAT 17:11

WWW.THEBEREANCALL.ORG

• DAVE HUNT, THEMELUES

• VËLL. XXV, NR. 7

• KORRIK 2010

## Inkuizicioni i ri

Dave Hunt

[Fragmentet janë marrë nga artikulli nga THEB i prillit të 1999, «Islami dhe ungjilli»].

Ishte viti 1569, në kulmin e Inkuizicionit Spanjoll të Katolicizmit në Hollandë. Dirk Uillemsi (Dirk Willems), një ndjekës i përlusur dhe besimtar i Jezus Krishtit, gjendje në burg duke pritur një vdekje përvëluese në turrën e druve. Krimi i tij? Sepse ishte ripagëzuar pasi kishte rrëfyer besim në veprën e përfunduar të Jezus Krishtit mbi kryq. Regjistrat zyrtarë të qytetit pohojnë se i burgosuri, «...duke ngulur këmbë si mushka në opinionin e tij [...] do të ekzekutohet në zjarr, deri në vdekje...».

Një ditë, Dirku, duke parë se qelia e tij ishte për një çast pa asnjë roje, e shfrytëzoi mundësinë për t'u arratisur. Ia mbathi përmes liqenit të akullit aty afër. Megjithatë, shumë shpejt ra alarmi dhe një «kapës hajdutësh» u dërgua të ndiqte burrin e arratisur. Duke dëgjuar kërcitjet e akullit mbrapa tij, Dirku u kthye dhe pa ndjekësin e tij duke depërtuar në ujën e akullit. Duke ndaluar për një çast, ai u kthye për të shpëtuar armikun e tij nga vdekja e sigurt. Me mirënjohje të thellë ndjekësi kërkoi që Dirku të lejohej të shkonte i lirë. Kjo kërkesë iu mohua. Data e vdekjes së Dirkut qëndroi po ajo. Të dhënat zyrtare, të ruajtura deri sot, na tregojnë që «...një erë e fortë nga lindja që fryu atë ditë, zjarri u largua nga pjesa e sipërme e trupit të tij [...] si pasojë e të cilës ky njeri i mirë pësoi një vdekje të ngadaltë».

A shohim në këtë ngjarje disa pasqyrimet të vetë vuajtjeve të Krishtit për ne mëkatarët? Shkrimi shpall që «Perëndia është dashuri». Dashuria është vetë natyra e Tij. Vepra e Perëndisë duke krijuar mjedisin e përkryer për njeriun tregoi me hollësi të rafinuara largpamësinë e Tij për marrësit e ardhshëm të dashurisë së Tij, që arriti kulmin në planin e Tij për shpengimin e njeriut mbas Rënies në mëkat. Qengji i flijimit përshkroi që më parë sakrificën përfundimtare të Birit të vetëmlindur të Perëndisë, kur, gjatë orëve të errëta të Kalvarit, ai derdhi zemërimin e Tij kundër objektit më të shtrenjtë të dashurisë së Tij. Nga kryqi erdhi thirrja e Jezusit: «Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?» Jezusi e dinte përgjigjen e asaj pyetjeje, edhe pse ai realitet ishte aq pikëllues. Biri i Perëndisë u vetë mëkat dhe kështu duhet të vuajë refuzimin e Atit të vet (2 Kor. 5:21).

A guxojmë ne të krahasojmë aktin e «shpengimit» nga Dirk Uillemsi me atë të Shpëtimtarit tonë? A nuk duhet që ne, si të krishterë, të marrim këtë hap përtej gëzimit të madh për shpëtimin tonë tek ai hap edhe

për të marrë rolin e qengjit sakrifikuës, siç bëri Dirk Uillemsi, kur nevoja e kërkon?

Le të hyjmë në një arenë tjetër, shumë larg nga kohërat e Inkuizicionit Spanjoll të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Ne kemi një «inkuizicion» tjetër që ndodh shumë më në lindje dhe që arrin përqindje alarmuese në ditët tona.

Në Arabinë Saudite, për shembull, gjendet një errësim i plotë mbi çdo gjë të krishterë: njëri nuk mund të mbajë me vete një Bibël nëpër rrugë ose të zhvillojë një studim biblik në vet shtëpinë e tij private. Madje edhe në ambasadën tonë, mbi të cilën valëvitet flamuri amerikan, shërbesat e kishave të krishtera janë të ndaluara. Zyrtarisht është dënimi me vdekje në Arabinë Saudite dhe në disa vende të tjera myslimane (dhe e detyruar jozyrtarisht kudo gjetkë) që një mysliman të kthehet apo konvertohet në një fe tjetër.

Vetëm myslimanët mund të jenë qytetarë të Arabisë Saudite. Madje edhe në ato vende Arabe ku *sheriati* (ligji islamik) nuk është i detyruar nga qeveria, ndikimi i islamit pengon lirinë e fjalës, të shtypit, të fesë dhe të ndërgjegjes. Edhe në territoret e Organizatës për Çlirimin e Palestinës (PLO), arabët e krishterë, të cilët dikur kishin liri nën sundimin e Izraelit, tani vuajnë persekutim, burgim dhe vdekje për besimin e tyre. Dhe akoma as OKB-ja as vet qeveria jonë nuk e kundërshton një tirani të tillë prapa perdes islamike. Myslimanët ngrenë xhami dhe adhurojnë lirisht në perëndim, por në vetë vendet e tyre ata u mohojnë të tjerëve të tilla liri. Në vend që të raportohet kjo hipokrizi, media e botës e mban atë të fshehur.

Islami u përhap me të madhe nën sundimin e Muhamedit dhe pasuesve të tij përmes *xihadit* («luftë e shenjtë»). Vetë Muhamedi planifikoi 65 ekspedita ushtarake dhe udhëhoqi 27 duke përfshirë këtu tradhti dhe sulm të hapur. Ky «ungjillëzim» i pabesueshëm bëri «të konvertuar» me miliona me anë të shpatës. Në kulmin e tij, islami kishte pushtuar të gjithë Afrikën e Veriut dhe pothuajse mori pushtetin e Evropës.

Islami vazhdon pushtimin e tij në mbarë botën. Pushtuesit në ditët e sotme janë miliona emigrantë të cilët i kthejnë njerëzit në fenë islame nëpërmjet shtrembërimit. Dikush shikon në TV gra të veshura sipas modës të cilat thonë se janë kthyer në fenë islame dhe që dëshmojnë për gëzimet dhe rrugët e tij paqedashëse. Sidoqoftë në Arabinë Saudite atyre u duhet të mbulohen me vel ku duken vetëm sytë, u duhet të veshin mantele të gjata e të zeza, nuk mund të ngasin një makinë, mund të jetë një nga katër bashkëshortet që zakonisht keqtrajtohen nga burrat e tyre, mund të divorcohet nga denoncimi i tij publik dhe

janë praktikisht skllave nën sundimin e sheriatit.

Qëllimi i sinqertë i islamit, i treguar në Kur'an (referimet e dhëna këtu janë nga tri versione) dhe *hadithe* (gojëdhëna të shkruara islamike), mbetet po ai: që ta sjellë gjithë njerëzimin në nënshtrim (ky është edhe kuptimi i fjalës «islam») dhe të vrasë ose robërojë të gjithë «të pafetë» (dmth, jobsimtarët në Allahun dhe Muhamedin profetin e tij - Sura 2:190-92; 4:76; 5:33; 9:5, 29, 41; 47:4 etj.). Islami (në bindje të Kur'anit dhe shembullit të Muhamedit) është forca lëvizëse mbrapa shumicës së terrorizmit sot. Sipas haditheve, Muhamedi shpalli: «Ora e fundit nuk do të vijë përpara se myslimanët të luftojnë me judenjët dhe myslimanët t'i vrasin ata».

Shumë perëndimorë në mënyrë naive e pranojnë Allahun, që frymëzoi Muhamedin, si Perëndinë e Biblës. Mirëpo Allahu s'ka bir dhe e mohon Trininë (4:171), është i pakuptueshëm dhe ishte idhulli/perëndia pagan e fisit të Muhamedit përpara lindjes së tij. Allahu u thotë myslimanëve, «Mos zini miq as judenjët as të krishterët [...] luftoni idhujtarët [të pafetë] kudo që t'i gjeni... Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër» (5:51; 9:5, 29, 41). Por Perëndia trini i Biblës dëshiron që njerëzit ta njohin Atë (Jer. 9:24), një njohuri që është e nevojshme për shpëtimin (Gjo. 17:3). Judenjët janë «populli i Tij i zgjedhur» (Eks. 6:7; Lev. 20:26; 1 Kro. 16:13; Psa. 105:6 etj.) dhe të krishterët janë fëmijët e Tij shumë të dashur (Rom. 8:16, 21; Gal.3:26; Efe. 1:5;5:1 etj.).

Në vend të konvertimit [kthim në fe tjetër] me forcë, Krishti tha se dishepujt [ndjekësit] e Tij nuk luftuan, pasi mbretëria e Tij nuk ishte e kësaj bote (Gjo. 18:36). Dhe vërtet, Ai u tha dishepujve të vet: «Duajini armiqitë tuaj, bekonit ata që ju mallkojnë, bëjuni mirë atyre që ju urrejnë dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin» (Mt. 5:44).

Krishti e dha jetën e Tij për të shpëtuar mëkatarët dhe ndjekësit e Tij duhet të jenë të gatshëm të japin jetët e tyre për ta çuar këtë lajm të mirë nëpër botë. Shpëtimi biblik është një dhuratë falas e paguar me anë të vdekjes së Krishtit, që tha: «Shkoni, pra, në mbarë botën dhe predikojini ungjillin çdo krijesë» (Mr. 16:15). Ky urdhërim përfshin edhe një miliardë myslimanët e sotëm. Ata paraqesin një sfidë të frikshme (dhe të pashmangshme) për çdo të krishterë. Por si mund t'jua çojmë ne ungjillin atyre që mund të vriten për të besuarit në të, ose që mund të na vrasin ne që jua ofrojmë atë atyre? E vetmja rrugë e sigurt për një mysliman që të fitojë paraqesjen është të vdesë duke luftuar të pabesët. Mirëpo Krishti vdiq edhe për myslimanët dhe dashuria e Tij na shtrëngon të ndajmë Lajmin e Mirë.

Përpjekjet për të ungjillëzuar myslimanët kanë patur pak sukses për arsye të qarta. Megjithatë, kohët e fundit ka qenë duke u adoptuar një mënyrë e re dhe në dukje e frytshme: përdorimi i shkrimeve myslimane për të paraqitur Krishtin. Hadithet dëshmojnë për lindjen prej virgjëreshe, jetën pa mëkat dhe mrekullitë e Krishtit, i cili quhet «Fjala e Allahut». Disa pjesë të Kur'anit, gjithashtu, flasin me konsideratë të lartë për Krishtin: që Ai u lind nga Maria kur kjo e fundit ishte e virgjër (Sura 3:45-47; 21:91 etj.); Ai është shembulli më i lartë (43:57); dhe që vetëm Ai është quajtur «Isa», që do të thotë Shpëtimtar (3:45). Ndërkohë që Muhamedi nuk ishte në gjendje të kryente mrekulli (17:90-96; 29:50-52 etj.), Krishti kreu mrekulli (2:252-53; 3:49); dhe ndryshe nga të tjerët si Moisiu i cili bëri mrekulli me urdhrin e Perëndisë, Jezusi bëri mrekulli nga vetë iniciativa [nisma] e Tij (26:63 etj.), madje edhe të ngjallë të vdekurin (3:49; 5:110; 36:78-79 etj.). Për më tepër, Kur'ani thotë se Muhamedi ishte një mëkatar (9:43; 40:55; 47:19; 48:2 etj.), por Jezusi ishte i pamëkat (19:17-19). Antikrishti (*Dexhali*) është një temë e rëndësishme e haditheve, që paralajmërojnë ardhjen e tij. Ai është quajtur «Krishti i rremë» i cili do të mashtrojë shumë afër fundit të kohës. Hadithet mësojnë se Jezusi do të kthehet në fund që të shkatërrojë Dexhalin. Besimi në «Ditën e Fundit» është një pjesë themelore e besimit mysliman (2:62).

Megjithatë, pavarësisht nga nderi dhe respekti i akorduar [i dhënë] Jezusit, Jezusi i islamit nuk është Jezusi i Biblës por «një Jezus tjetër» (2 Kor. 11:4). Megjithëse në pjesët e tij të para Kur'ani të paktën nderon pjesët e Biblës si «Libri» dhe judenjtë e të krishterët bashkë si «njerëzit e Librit», ai shpesh e hedh poshtë Biblën: ai mohon se Jezusi është Perëndi (3:59, 62; 4:171) dhe se Ai vdiq mbi kryqin (4:157-58; 5:116-20) për mëkatet tona. Gojëdhënat e hershme thonin se me kërkesën e Krishtit një dishepull i ngjashëm me Të e çliroi Atë nga kryqi duke vdekur në vendin e Tij. Megjithatë, pjesët e tjera duket se shpallin se Krishti me të vërtetë vdiq (3:33, 55; 5:117; 19:33) dhe shumë studiues islamikë zgjedhin këtë pikëpamje sot. Kur'ani mohon se dikush mund të vdesë për një tjetër (17:13-15; 35:18). Në të vërtetë, ai thotë se «asnjë shpirt i ngarkuar» [dmth, mëkatar] nuk do ta bartë barrën [mëkatit] e tjetrit». Përderisa Jezusi ishte pa mëkat, Ai duhet të jetë një përjashtim.

Që mëkatarin të falet në mënyrë të drejtë, Krishtit iu desh të paguante dënimin e kërkuar nga drejtësia e Perëndisë; por ky koncept është i huaj për islam. Kur'ani përmban paqartësi: «Pendim i pranueshëm të Allahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije e pastaj shpejt pendohen tek Allahu... Vërtet! Allahu fal [...] atij që dëshiron...» (4:17, 116). Nuk janë shpjeguar as «mosdija» as «shpejt», as pse Allahu fal disa dhe jo të tjerët. As nuk garanton pendimi falje.

Nga ana tjetër, Bibla u ofron falje të

gjithëve. Madje Krishti vdiq për të shpenguar ata të cilët e urren Atë dhe i kërkoi Atit të Tij që t'i falte ata të cilët e kryqëzuan Atë (Lu. 23:34).

Në jetën reale, falja e Allahut kurrë nuk vjen në kohë për të ndaluar një dorë, këmbë apo vesh nga prerja si ndëshkim për vjedhje. Me qindra irakianë të gjymtuar nga ky dekret i panjerëzishëm islamik largohen nëpër kampe që janë në kufi me atë vend. E prapë, rrëmbimi i fëmijëve nuk kërkon një gjymtim të tillë sepse një person nuk konsiderohet si pronë. Edhe kurvërimi nuk kërkon një gjymtim të tillë, ndërsa një vjedhje e vogël e kërkon.

Mospajtimet e Biblës me Kur'anin janë justifikuar duke thënë se Bibla u korruptua. Por Kur'ani u dërgua për të qënë «si një mbrojtës» për Biblën (5:48); prandaj, nëse Bibla u korruptua, Kur'ani dështoi. Vetë Libri i Shenjtë mysliman pohon se shumë prej tekstit të tij është i errët (3:7); madje myslimanëve iu duhet t'u kërkojnë sqarim «Njerëzve të Librit [Biblës]». (21:7)!

Gjithashtu Kur'ani bie në kundërshtim edhe me vetveten: Allahu krijoi gjithçka «sa hap e mbyll sytë» (54:49, 50), «për dy ditë» (41:9, 12), «brenda katër ditëve» (41:10), «brenda gjashtë ditësh» (7:54; 10:3; 32:4), «në një ditë» e barazuar me «një mijë vjet» (70:4); Jezusi nuk është Biri i Perëndisë (4:171), dhe prapë Ai është (19:17-21) etj.

Duke cituar Kur'anin dhe hadithet ne duhet të shmangim përshtypjen se jemi duke vërtetuar këto shkrime. Merr parasysh diskutimin e Palit me filozofët mbi Areopag: «...sikurse kanë thënë disa nga poetët tuaj» (Vep. 17:28). Pali nuk po sugjeronte se këta shkrimtarë ishin të frymëzuar nga Perëndia – dhe ai shkoi përtej tyre për të paraqitur ungjillin. Në të njëjtën mënyrë, ne duhet të shmangim me dashuri përtej asaj se çfarë thotë Kur'ani dhe hadithet për Jezusin për të paraqitur ungjillin e vërtetë; përndryshe nuk kemi një bazë për shpëtimin.

Që një mysliman të bëhet një i krishterë i vërtetë ai duhet të shpallë të pavlefshëm perëndinë e rremë të islamit, Allahun, dhe ungjillin e tij të rremë të shpëtimin e anë të veprave. Për fat të keq, ungjillit po i bëhet komprometim për ta bërë atë tërheqës për myslimanët. (Në Perëndim ai po bëhet tërheqës për të gjithë). Shumë «të konvertuar» nuk e kanë kuptuar kurrë ungjillin dhe kështu nuk kanë besuar atë që është «fuqia e Perëndisë për shpëtimin e cilitdo që beson» (Rom. 1:16). Pa dyshim që ungjilli nuk gjendet në Kur'an. Sidoqoftë me sa duket myslimanët po shpëtohen duke dëgjuar atë. Autori i «*Urra lidhëse: Krishterimi dhe Islami*» (NavPress, 1997) na jep dëshminë e një myslimani «të kthyer» te krishterimi në Pakistan (fq. 27):

Teksa po dëgjoja Kur'anin që lexohej në radio ditë për ditë, dëgjova se Krishti ishte shumë i nderuar [...] dhe i vendosur pranë Perëndisë. I thashë vetvetes, «Nëse dëshiroja dikë që të ndërmjetësonte për mua tek Perëndia, a do të kishte ndonjë që do ta bënte këtë punë më mirë se Krishti...?» Dhe kështu u luta, »Zot Isa [Jezus] të lutem më ndihmo. Dëshiroj që

t'ia përkushtoj veten Perëndisë nëpërmjet teje. Përderisa ti je shumë i nderuar dhe i ulur pranë Tij, ti mund ta bësh këtë?».

Më pas autori komenton: «Mbas kësaj, ai u ndje si një njeri i ndryshuar, më i lumtur se më parë...».

Ky është një mashtrim i ngjashëm me atë të atyre që thonë: «O Zot, o Zot, a nuk profetizua ne në emrin tënd? [...] dhe kemi bërë shumë vepra të fuqishme në emrin tënd?»; të cilëve Zoti iu përgjigjet: «Unë s'ju kam njohur kurrë; largohuni nga unë...» (Mt. 7:21-23). T'i kërkosh Isas të islamit të ndërmjetësojë për dikë nuk të shpëton. Njeri duhet të besojë ungjillin për t'u shpëtuar: «Që Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve» (1 Kor. 15:1-4); «Që kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme» (Gjo. 3:15). Ky ungjill nuk është në Kur'an, dhe nuk gjendet asgjë në këtë dëshmi «të konvertuari» të tregojë se ai e njihte apo e besonte atë.

Po ai autor deklaroi se «60 përqind e myslimanëve të cilët janë drejtuar me metodat e shpjeguar në këtë libër e vendosën besimin e tyre në Krishtin...». Por Krishti dhe apostujt e Tij nuk përjetuan një përqindje të tillë të kthyerish. Jezusi tha se pak do të shpëtohen (Mt. 7:13, 14). Autori në mënyrë entuziaste iu referohet myslimanëve të kthyer në Krishtin «ndërsa qëndrojnë [për vite] në vathë të komunitetit të tyre islamik [...] pa u bërë të neveritshëm për vetë komunitetin e tyre» (fq. 10). Por Jezusi i paralajmëroi dishepujt e vet: «Dhe të gjithë do t'ju urrejnë për shkak të emrit tim...? (Mt. 10:22; Gjo. 15:20). Të gjithë, përveç myslimanëve?»

Ne duam të jemi të urtë dhe të mos skandalizojmë në mënyrë të panevojshme me paraqitjen tonë të ungjillit (1 Kor. 10:32), qoftë myslimanët apo cilindo për të cilin Zoti na jep hir për të paraqitur «pasuritë e papërshkrueshme të Krishtit» (Efe. 3:8). Por ka një skandal të pashmangshëm për shkak të Krishtit (Mt. 26:31; Rom. 9:33; 1 Pje. 2:8) dhe të Kryqit (Gal. 5:11). Ne duhet të jemi të kujdesshëm që të paraqesim me të vërtetë ungjillin që njerëzit duhet ta besojnë për t'u shpëtuar. Do të ishte veçse një dënim për shpirtat nëse në zellin tonë për ta bërë botën që të pranojë ungjillin ne predikojmë një ungjill tjetër të pranueshëm nga bota.

Le të kujtojmë Dirk Uillemsin, i cili, si përfaqësues i Krishtit mbi tokë në një epokë tjetër, e përqafoi me gatishmëri Kryqin që armiku i tij të jetonte. Edhe ne, gjithashtu, le t'u shërbejmë jetë armiqve të Krishtit në epokën tonë, edhe ndërsa i shohim ndjekësit e Allahut duke shërbyer vdekje. Kryqi shpall që Perëndia është dashuri, një dashuri që pushton përmes derdhjes së vetë gjakut të çmuar të Krishtit për mëkatarët:

Me dobësi dhe disfatë Ai fitoi kurorën e lavdishme; i shkel i me këmbë tërë armiqët duke u shkelur vetë.

Çfarë fitore!